



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Fushe-Arrez me, 13.03.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Mirembajtje kanale vaditese”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
98341110-9

VLERA E FONDIT LIMIT – 1 595 000 (nje million e peseqind e nentedhjet e pese mije) **leke pa TVSH.**

Në bazë neni 77,pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 6 germa a, c, ç, pika 8 dhe neni 43 pika 2 germa b,pika 4 dhe pika 6 autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjithë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore ,sipas ligjit 9632 date 30.10.2006 " Per sistemin e taksave vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 germa d.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve i Vitit 2021, 2020, 2019 i konfirmuar nga autoritetet përkatëse si dhe i shoqëruar me raport auditimi nga Ekspert Kontabël i Liçencuar (organ tatimor) nëse kërkohet sipas legjislacionit në fuqi..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të madhe se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punes se bere, per te vertetuar permbushjen me sukses te puneve.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontrates dhe natyra e punës së bërë e shoqëruar me fatura tatimore dhe cdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me te madhe 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma a, e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 30 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga Ministrisë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Liçensë për zbatim punimesh pikat

NP 1	A	Punime gërmimi në tokë
------	---	------------------------

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr.8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar, VKM Nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”e ndryshuar

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të liçences profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që ne kërkojmë të prokurojme dhe pikat e kërkuara të licenses janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **11 (njemdhjetë) persona** .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 OE duhet te disponoje Personeli/pajisje si me poshtë:

a-Teknik i mesem ndertimi/topograf pjese e stafit teknik te shoqerise me deshmi kualifikim, kontrate pune.

b-Vegla pune dore(kazma dhe lopata) cop (15+15).

c-Jelek identifikues cop 11

d-Punetori e thjeshte 10(njezet).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6, gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak se gjatë zhvillimit të punimeve është e domosdoshme ruajtja e pjerrtësisë në gjatësi për objektet .

2.3.5 Punimet e realizuara nga subjekti do të merren në dorezim nga një komision ku në përberje të tij do të jenë përfaqësues nga Bashkia Fushe-Arrez dhe nga Njesite Administrative perkatese ku do të hartohet një process-verbal i perbashket per te gjithë objektet dhe te neshkruhet nga palet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur meqenësë objektet janë të vendosura në fshatrat përbërës të njësive Administrative është e domosdoshme ndjekja e punimeve nga administratorët të cilët do të ndjekin të gjithë fazat e tyre dhe në fund do të hartojnë procesverbalet e dorzimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT